# DËSHMI ARKIVI

**A-456447**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Ministrja kopjace”/ Klodiana Spahiu në krye të Shëndetësisë, punimi i diplomës rezulton plagjiaturë |
| ADRESA | `https://dosja.al/aktualitet/ministrja-kopjace-klodiana-spahiu-ne-krye-te-shendetesise-punimi-i-di-i514913` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 18 shtator 2026, 20:07:06 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 19:56:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f458087460e047810d12aadbc159e38c48388b3ff12d2c7931b2d09384b490ea` |
| TEKSTI | `f5ad5f9c21c26bbfe872e3c870ed7a52a5af7b2f50638505f40e19faef8b4e68` |
| PAMJA | `d04db104e1cd6b4ce676a705c3dd924ac42e4d692a9c49fd2f7834f1556bdfc6` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `375c18a974520112b252be3ed69854b98131d411cbb4029102859c2f8268da3e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `f47cbc6d520bd6b958b6f20f356cb94c690d513120412a653d4bc3fd831cb866` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/375c18a974520112b252be3ed69854b98131d411cbb4029102859c2f8268da3e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LIVE UPDATES ↘

2 ORE ME PARE
111 ditë revoltë kundër qeverisë, qytetarët nuk e ndalin rezistencën: Rama, jepe dorëheqjen

9 ORE ME PARE
Pas vendimit të Hagës, Prishtina ngrihet në protestë/ Policia kërkon dokumente identifikimi për pjesëmarrësit, protestuesit kundërshtojnë

12 ORE ME PARE
"Protestat ndaj qeverisë janë demokraci"/ Rama: Gjykata Kushtetuese nuk i dikton Kuvendit si të votojë, të kërkosh rritje sa herë rriten pagat e të tjerëve është lajthitje

1 DITE ME PARE
110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mblidhen sërish në Bulevard: Arrestoni Ramën!

Aktualitet

# “Ministrja kopjace”/ Klodiana Spahiu në krye të Shëndetësisë, punimi i diplomës rezulton plagjiaturë

Pas propozimit të kryeministrit, të martën e 8 shtatorit Kuvendi votoi me 79 vota pro dekretin e Presidentit Bajram Begaj për emërimin e Klodiana Spahiut si ministre e Shëndetësisë, ndërsa kjo e fundit nuk i fshehu dot emocionet.

dosja
18 Shtator 2026, 21:56
Nga E. D




**TIRANË-** Të mërkurën e 2 shtatorit 2026, zonja Evis Sala dha dorëheqjen nga posti i ministres së Shëndetësisë. E cilësuar si ministrja e Shëndetësisë më jetëshkurtër në 4 mandatet e qeverisë Rama, Sala u largua me pretekstin se do të vijojë projektet e saj akademike. Posti i Ministres së Shëndetësisë iu besua deputetes së qarkut të Durrësit, Klodiana Spahiu.

Pas propozimit të kryeministrit, të martën e 8 shtatorit Kuvendi votoi me 79 vota pro dekretin e Presidentit Bajram Begaj për emërimin e Klodiana Spahiut si ministre e Shëndetësisë, ndërsa kjo e fundit nuk i fshehu dot emocionet.

Ndërkaq, pas betimit te Presidenti më datë 11 shtator, zonja Spahiu mbërriti në Ministrinë e Shëndetësisë për ceremoninë e prezantimit me stafin dhe aty u përball me gazetarin Freard Rista, i cili e pyeti: Si do ta drejtoni Shëndetësinë shqiptare kur e keni punimin e diplomës plagjiaturë?

Ministrja më e re premtoi çudira në këtë sektor, duke këshilluar gazetarin që të bëhet njeri më i mirë.

Përtej këshillës, duhet të sqarojmë publikun lidhur me plagjiaturën e ministres Spahiu, denoncuar më herët nga studiuesi Taulant Muka. Paragrafi hyrës i punimit të ministres Klodiana Spahiu mban vitin 2018 dhe flet për ngarkesat e ventrikulit të majtë te pacientët me diabet të tipit 2 dhe vendi i studimit është Spitali i Durrësit.

Por zonja Spahiu nuk e ka shkruar vetë këtë paragraf, pasi e ka marrë fjalë për fjalë nga punimi i dy doktorëve koreanë, WangSoo Lee dhe Jaetaek Kim, punim i vitit 2017 për kardiomiopatinë diabetike.

*“Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një person që ka mashtruar, ka falsifikuar dhe ka marrë diçka që nuk është e vetja dhe e ka përvetësuar si të vetën dhe ministrja nuk reagon. Nga ana etike, në radhë të parë kemi një problem, sepse po bën realitet që është diku tjetër, realitet që ti nuk e ke vërtetuar, nuk e ke prekur apo nuk e ke studiuar”,*

editoriale

Irena Beqiraj
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika
Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 18 SHTATOR 2026, 17:07
Doli nga qelia dhe shkoi në spitalin Salus/ Veliaj kishte thyer këmbën duke luajtur futboll në paraburgim, sot shkoi për të bërë grafinë

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 20:00
FOTO/ Aksidenti në Athinë, këta janë tre të rinjtë që humbën jetën tragjikisht

shprehet studiuesi Muka, i cili thekson faktin se kjo praktikë na kushton shumë si popull dhe si shtet.

Nëse flasim ende për pjesën e prezantimit të punimit shkencor, vëmë re se zonja Spahiu, pasi mbaroi punë me dy kolegët e parë, lirisht merr sërish copy-paste dy paragrafë nga mjeku serb Brane Loncarevic.

Ky i fundit, teksa trajton problematikën e kardiomiopatisë diabetike asimptomatike në praktikën e përditshme, citon ndër të tjera se "asnjë nga pacientët tanë me diabet nuk kishte hipertrofi të ventrikulit të majtë, masa e ventrikulit të majtë dhe indeksi i masës së ventrikulit të majtë ishin të rritura krahasuar me pacientët e kontrollit të përputhur".

Mos harrojmë se këta individë, mbi të cilët është bërë studimi, janë pacientë të mjekut serb, të cilët me një "copy-paste", zonja ministre i ka bërë pacientë të spitalit të Durrësit.

Por nuk është mjaftuar me kaq, pasi nga Serbia zonja Spahiu ka kaluar në Greqi, duke vendosur fjalë për fjalë një copë të punimit të vitit 2009 të mjekut Alexander Stefanidis, i cili ka trajtuar ndryshimet anatomike dhe funksionale të ventrikulit të majtë gjatë plakjes te të rriturit me diabet të tipit 2.

Pra, pacientët e vitit 2009 të spitalit grek i kemi marrë dhe i kemi sjellë në 2018 në Durrës, duke dalë me të njëjtat përfundime.

Në kapitullin 2, materialet dhe metodat, zonja ministre ka ndryshuar vetëm vitin e studimit dhe numrat e pacientëve të marrë për analizë, ndërsa metoda është e marrë nga ajo që ka shkruar mjeku grek Alexander Stefanidis.

*"Në çdo vend të Europës plagjiatura është mashtrim, vepër penale, dhe në Shqipëri personazhe të tillë jo vetëm që duhet të kishin dhënë dorëheqjen dhe të ishin larguar nga jeta publike, por duhet të ishin marrë masat që këtyre personave t'u ishin hequr titujt, të kishin kthyer paratë që kanë marrë për shkak të këtyre titujve dhe të ishin krijuar të gjitha rregullimet ligjore apo legjislative që këto fenomene të parandaloheshin"*, përfundon studiuesi Muka./Piranjat news

evis sala

## Sondazh

Poll

Aktualitet

18 Shtator 2026, 21:54

# "Nuk duam të ikim nga Shqipëria, por nga ju"/ Monologu i një brezi që nuk ju ka frikë

Mirëmbrëma. Unë quhem Brunela Mërtiri dhe jam 24 vjeç. Jam pjesë e asaj që ju e quani "gjenerata Z". Kjo &eu...

PAMJET/ Për të tretën natë me radhë,

POLITIKE 18 SHTATOR 2026, 19:20

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, Christopher Hill: Thaçi nuk ka qenë i përfshirë në vepra të paligjshme

## më të klikuarat

EKSKLUZIVE/ Erion Veliaj del nga qelia, kryebashkiaku shtrohet në spitalin Salus

Hetimet për nënshkrimet e partisë/ Parlamenti Europian i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditi Latinopoulou

Pagat e magjistratëve/ Shefja e Thesarit, Tiranë: Kreva pagesën e muajit Gusht 2026. Rrogat i bllokoi Malaj...

Takimi sekret në Buenos Aires/ Mediat urugaiane: DEA paralajmëron përparimin e mafies shqiptare në rajon

## insights

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

## Moti

Powered by tomorrow.io

qytetarët mblidhen në shesh kundër vendimit të Speciales, djali i Thaçit e Veselit mes protestuesve

Aktualitet

18 Shtator 2026, 21:25

---

Flamingot që "zgjuan" një popull kundër qeverisë/ Revolta më e madhe qytetare në 30 vite

Aktualitet

18 Shtator 2026, 21:22

---

"Vendi ynë më i rëndësishëm se gjithçka"/ Aktivisti Arben Kola thirrje të rinjve: Të bëhemi bashkë, të shpëtojmë Shqipërinë

Aktualitet

18 Shtator 2026, 21:00

---

Nga dorëheqja e Ramës, te shfuqizimin i ligjit për investimet strategjike, aktivistja rendit kërkesat e protestuesve

Aktualitet

18 Shtator 2026, 20:57

---

Aktualitet

18 Shtator 2026, 20:34

# Edison Lika thirrje qytetarëve: Reagoni ndaj padrejtësive! Ky regjim nuk rrëzohet me dy ditë protestë por me njerëz që rezistojnë deri në fund

Edison Lika TIRANË- Aktivisti Edison Lika u ka bërë thirrje qytetarëve që të vijojnë rezistencën dh...

---

Dita e 111-të e protestës/ Mbyllen fjalimet, nis marshimi i qytetarëve në rrugët e Tiranës

Aktualitet

18 Shtator 2026, 20:51

## "Ne jemi të traumatizuar"/ Rrëfimi i gruas që denoncoi dajën e Zegjine Çaushit: Babait ia ka këputur këmbën, më kërkuan të tërheq...

Aktualitet

18 Shtator 2026, 20:24

## FOTO/ Aksidenti në Athinë, këta janë tre të rinjtë që humbën jetën tragjikisht

Aktualitet

18 Shtator 2026, 20:00

## 1-vjeçari dëmton dorën në grirësen e mishit, transportohet me helikopter drejt Tiranës

Aktualitet

18 Shtator 2026, 19:48

MË SHUMË





Prishtina proteston për vendimin e Hagës, djali i Thaçit e Veselit mes protestuesve


Dita e 111-të e protestës/ Mbyllen fjalimet, nis marshimi i qytetarëve në rrugët e Tiranës


Protesta në Tiranë/ Nis marshimi drejt Kryeministrisë, thirrje: Jepe dorëheqjen


Rama: Euro e dobët, duhet reflektim te çmimet

## Prishtina proteston për vendimin e Hagës, djali i Thaçit e Veselit mes protestuesve

Shiko video te tjera

KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]

AKTUALITET
POLITIKE
EKONOMI
BOTA
SPORT
ART&ARGËTIM
INSIGHTS

**Drejtor: Enton Abilekaj**

**Kryeredaktor: Izmir Akulli**

**Gazetarë:**
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

INSIGHTS
EDITORIAL
KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES
MUNDESUAR NGA Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.